

**Fjala e z. Ardjan Mazniku,
Zv. Minister i Arsimit dhe Sportit**

I nderuar z. President K Nikollaj,
Të nderuar Sindikalistë,
I nderuar z. Minister Veliaj,
I nderuar z. Vasili,

Është një kënaqësi e veçantë që më jepet mundësia që në emër të Ministrisë Arsimit dhe në emër të Ministres të ju përshëndes sot në Kongresin tuaj të 5 të. Jam tej mase i impresionuar nga ajo që është motoja e këtij kongresi: “Se bashku me të fortë së bashku ne Europë” sepse kur bëhet fjalë për të shkuar në Europë nuk është vetëm qeveria për të shkuar në Europë, nuk është biznesi që mund të shkojë në europë, por vetëm e gjithë shoqëria së bashku, së bashku me lëvizjen sindikaliste se bashku me punëtorët, mundet të gjithë së bashku të shkojmë në europë. Ju përshëndes për këtë moto që është trupëzimi më i mirë i asaj që duhet të jetë për të ardhmen e Shqipërisë drejt BE-së. Dialogu trepalësh ka rëndësi të veçantë pasi vetëm kështu shoqëria jonë mund të funksionojë më mirë ndaj ne si Ministri Arsimit kemi patur vëmendje të posaçme që në secilën nga reformat që ndërmarim të sigurohemi që secili nga aktorët shoqërorë është përfshirë dhe është diskutuar me të.

Së fundmi kemi nisur reformën në drejtim të trupës mësimore ne Shqipëri ku kemi konstatuar se ka një numër shumë të madh mësuesish pa arsim përkatës, ose jashtë profilit, ku preken interesat e rreth 160 mijë nxënësve. Nëpërmjet një procesi të drejtë transparent e publik do të garantojmë mundësinë që mësuesit që do të merren në punë në të ardhmen të jenë pjesë e një procesi transparent e konkurrues. Secili qytetar të dije se si do të jetë mësuesi për fëmijët e tij. Nuk është vetëm çështja e një grupi mësuesish apo nxënësish, por nga arsimi preket gjithë popullata. Secili prej nesh ndërlidhet ne një moment të caktuar me arsimin, shkollën apo universitetin. Mendojmë se duke riparuar pjesën e mekanizmit të punësimit në arsim mendojmë se mundet të përmirësojmë arsimimin e fëmijëve tanë dhe të gjithë së bashku mund të shkojmë drejt BE-së. Ministria e Arsimit është shumë e gatshme të bashkëpunojë me secilin nga aktorët social në mënyrë të veçantë me sindikatat, me KSSH-në në mënyrë që të drejtat e të punësuarve në sistemin e arsimit të jenë të garantuara.

I uroj ditë të mbarë dhe frytdhënëse Kongresit. Faleminderit.